

GAZMEND LEKA - MISTIKU



Gjithnjë më ka tërhequr pa masë arti i *Gazmend Lekes*. Gjithnjë më kanë ngacmuar *truket e tij* artistike. Atmosfera në të cilën pluskojnë heronjtë e tij. Misticizmi, si edhe fluturimet imagjinare në të cilat na shtegëtojnë veprat e tij. Me universin artistik të *Gazmend Lekës* u njoha qysh në fëmijëri, si krijuesi i filmit aq të dashur për mua “*Dy Gosti*” (prodhim i Kinostudios “*Shqipëria e Re*”, 1982), e më pas në rolin e piktorit-ilustrues tek libri i *Mitrush Kutelit* me titull “*Tregime të moçme shqiptare*”(1987). Arsyeja që më pëlqenin atëhere

skicat apo personazhet e tij të animuar gjëndeje pikërisht në faktin se ato, dashje pa dashje, ushqenin fantazinë time fëmijore me ndjesi, emocione e imazhe, prej të cilave e kasha të pamundur të shkëputesha lehtësisht. Me pikturën e *Lekës* u njoha diku aty nga fundi i viteve '80, dhe jam përpjekur të jem në kontakt me të edhe përgjatë ketyre viteve. Ajo që bie në sy menjëherë sa ndesh artin e tij është realiteti tërësisht personal që gjallon në sipërfaqet e sheshta me të cilat operon. Mistikja, spiritualja, fantastikja, elementet e ndryshëm mitologjik dhe historik, të filtruar këta prej subjektivitetit mendor dhe emocional të krijuesit të tyre. Shpesh herë kam ndjesinë se *Gazmendi* është një përçues dhe vazhdues dinjitoz i kërkimeve artistike, por edhe spirituale të mjeshtrave ballkanas të periudhës bizantine dhe pasbizantine. Po ashtu, ndjej se arti i tij ka thithur nocione estetike dhe filozofike nga kjo periudhë kaq e pasur për sa i përket vlerave në trajtë, apo edhe atyre konceptive. Fakti që mjaft punë të tij janë punuar në dru; evidenca e një realiteti dy-dimensional, me mungesë (*apo injorim*) të ligjeve të perspektives; një sërë hulumtimesh me problematikë spirituale (*fetare*); drita që pershkton pikturat (*e cila të kujton shumë herë dritën që lëshon flakëza e qiririt*), e mefshtë, e ngrohtë, dredharake dhe e brishtë; si edhe mungesa e gravitetit të elementëve pjesë përbërese të heronjve në veprat e tij, janë urëza që e lidhin këtë krijues modern me pikturën kishtarë dhe kryesisht me ikonografinë bizantine të rajonin ballkanik. Vizatimi dinamik, ekzistenca e një lloj simetrie anarkiste, elementët gjeometrikë, simbolika e kudogjëndëshme, të thjeshtëzuarit e botës në mënyrë esenciale, pasuria stilistike, teknika tepër e rafinuar, si edhe mjeshhtëria e pashoqe e penelatës, e vendosin *Gazmend Lekën* në një nga artistet më të rëndësishëm të brezit të vet në *Shqipëri*, por edhe më gjere, dhe në të njëjtën kohë e shndërrojnë në një nga udhërrëfyesit e rrugës që duhet të ndjekë arti shqiptar sot - në vitet dhe kohërat e kolerës.

TONI MILAQI
19 NËNTOR 2008